



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut (Junik), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve me vlerë totale prej 161,589€ ku nga kategoria e investimeve kapitale dhe subvencione dhe transfere janë paguar për shpenzime paga dhe shtesa.
- A2 Mangësi në evidentimin e pasurisë dhe mos aplikimi i zhvleresimit, Komuna nuk ka aplikuar zhvlerimin vjetor për pasurit jo financiare.
- A3 Mbivlerësimi i të hyrave, Komuna ka prazantuar të hyrat jo tatimore në PFV e vitit 2024, jo në përputhje me kërkesat për raportim, duke reflektuar në mbivlerësimin e tyre prej: 11,966 €.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Junikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A4 Vonesa në pagesën e obligimeve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Junikut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Junikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Junikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Junikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Junikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregulave financiare për pagesën e obligimeve brenda afateve ligjore, menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e pagave, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe klasifikimin e saktë të shpenzimeve.

Raporti i auditimit ka rezultuar me pesë (5) rekomandime të reja dhe një (1) rekomandim i përsëritur. Ne do ta përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Po ashtu theksojmë se pagesat e realizuara nga thesari bazuar në vendimet gjyqesore permbarimore për kontraten kolektive në arsim për vitin 2024 ishin në shumën totale 202,326€ prej tyre borgji kryesor 110,284€ ndersa shpenzimet e interest dhe procedurale të gjykates/permbarimi 92,041€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi i pa saktë i shpenzimeve

Gjetja	Sipas neni 18 pika 3 e Rregullës Financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Në dy (2) raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendime permbarimore, me vlerë totale prej 161,589€, në kategori të gabuar ekonomike, ku nga investimet kapitale janë paguar 160,365€ dhe nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere 1,224€ për kontratëmn kolektive ku përfshihen paga jubilarë, shujta e të tjera, që duhej të klasifikoheshin si shpenzime për paga dhe meditje. Këto gabime kanë ndodhur për shkak të pagesave të realizuar nga Thesari rrjedhojë e vendimeve gjyqesore/përparimbore.
Ndikimi	Shpenzimet e realizuara nga kategori të pasakta ndikojnë në mbivlerësim apo nënvlerësimin e kategorive buxhetore, duke sjellë pasqyrim jo të saktë të shpenzimeve në Pasqyrat Vjetore Financiare (RVF).
Rekomandimi A1	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet e sakta buxhetore, ose të bëhet ridestinimi i mjeteve kur është e nevojshme, në mënyrë që të gjitha pagesat të regjistrohen sipas kodeve të duhura ekonomike të planit kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mangësi në evidentimin e pasurisë dhe mos aplikimi i zhvlerësimit**Gjetja**

Sipas nenit 6 paragrafi 3 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu sipas nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rregullorës. nr 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore.

Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Nga testimet tona kemi vërejtur që komuna nuk e aplikon zhvlerësimin për të gjitha pasuritë e regjistruara në regjistrin kontabël në SIMFK (pasuritë kapitale me vlerë mbi 1000 Euro). Është vërejtur mos aplikimi i zhvlerësimit te projektet si: vendosja e kamerave për siguri publike (39,772€) dhe ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit të ujrave të zeza (9,000€), gjithsej vlera origjinale ishte prezantuar edhe të shumta në libër që kap shumën totale 48,773€, dhe zhvlerësimi i akumuluar ishte 0€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi

Mos regjistrimi individual i të gjitha pasurive me detajet e tyre si dhe mos përllogaritja e zhvlerësimit rezulton në prezantim jo të drejtë të PFV dhe mbivlerësim të vlerës së tyre.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mbivlerësimi i të hyrave****Gjetja**

Sipas Rregullores së MF-së Nr.01/2017 për raportimin financiar vjetor të Organizatës Buxhetore, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, PFV duhet të prezantojn informata të verteta dhe të sakta.

Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024, pjesa hyrjes së parasë gatshme në LLVTH, shënim nr 9 të hyrat jo taimore janë prezantuar në vlerë prej 69,000 euro është dashtë të prezantohen në vlerë prej 57,507 euro, kemi një mbivlerësim për 11,966 euro.

Janë prezantuar si pranime edhe të hyrat nga gjobat e policisë në vlerë prej 11,996 euro, të hyra gjobat e policisë administrohen nga MPB dhe regjistrohen si hyrje e parasë në LLVTH, nënlogarin bankare të Policisë së Kosoës në regjistra kontabël në SIMFK në kuadër të MPB-se regjistrohen si pranime të parasë dhe prezantohen në Raportin vjetor financiar të

MPB-se.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme për përmirësimin e gabimeve në PFV.

Ndikimi

Pasaktësitë e identifikuara me rastin e prezantimit të informatave në PFV dhe mungesa e informatave të plota dhe të sakta në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare ndikon në prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se PFV për vitin 2025 janë të plota dhe të sakta, si dhe janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme për përgatitjen e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja

Sipas nenit 37.2 dhe neni 39 i LMFP, përcakton që ZKF i OB është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës pas pranimi të faturës, si dhe të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Obligimet e papaguara për vitin 2024 në total arrijnë shumën prej 24,571€ që krahasuar me vitin paraprak ka rritje prej 10,320€. Bartje të obligimeve të papaguar kemi vërejtur edhe në periudhën paraprake.

Kemi vërejtur se në detajet e raportit për detyrimet (faturat) e pa paguara ka të evidentuara fatura nga muaji korrik deri në fund të vitit 2024 të cilat ende nuk janë paguar dhe ka vonesa në pagesën e tyre.

Kjo ka ndodhur për shkak të mospagesës me kohë të detyrimeve financiare, për të cilat nuk ishte bërë planifikimi në buxhet.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave në pagesa, komuna rrezikon të përballet me kosto shtesë për interesa, gjoba apo shpenzime gjyqësore të kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të forcojë kontrollet financiare dhe të sigurojë hartimin e një analize të detajuar buxhetore, në mënyrë që të gjitha obligimet të paguhen me kohë dhe të shmangen vonesat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Vlera e paraqitur në RVF e kategoris ekonomike Pagat dhe shtesat është 1,472,175.€, gjersa realizimi gjatë vitit është në shume prej: 1,471,340 €, apo 99.94% të buxhetit final.

Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtorëve

Gjetja

Sipas nenit 6 të Ligjit të pagave nr. 08/L-196, paga përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji.

Nga testimi ka rezultuar se komuna e Junikut, kishte paguar paga për tri (3) zjarrëfikës dhe pesë (5) pyllëtar të cilët nuk kanë ofruar shërbim për komunën.

Sipas zyrtarëve të komunës këtyre punonjësve paga iu është paguar nga komuna, mirëpo ata nuk janë evidentuar në regjistrin e vijueshmërisë në punë të komunës. Rrjedhimisht ata nuk janë evidentuar në regjistrat e komunës për vijueshmërinë në punë dhe as nuk kanë bërë as kërkesa për pushim dhe të tjera në komunë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos menaxhimit të duhur të vendimit për transferrin e këtyre kategorive të punonjësve.

Ndikimi

Dobësit në transferrin e punonjësve nga një institucion në tjetrin, mund të ndikojnë që pagesa e pagave dhe kompenzimeve të tjera të bëhen pa e marrë shërbimin për të cilin janë angazhuar. Mos evidentimi i punonjësve në regjistrin e vijueshmërisë në punë rezulton me pagesë të pagave pa ofruar shërbime në njërin anë, ndërsa në anën tjetër e pengon komunën që të rekrutojë punonjës për vendet e punës nga të cilat nuk merr shërbime.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të marrë veprime që punonjësit e transferuar në institucionet tjera të largohen nga lista e pagave të punonjësve të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna e Junikut në RVF e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 309,148€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 236,032€, ushtrimi i veprimtarisë 70,916€ dhe qiraja nga objektet publike 2,200€.

Çështja A5 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në RVF e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 309,148€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 236,032€, ushtrimi i veprimtarisë 70,916€ dhe qiraja nga objektet publike 2,200€, vetëm tatimi në pronë është rritur për 30,485€ në krahasim me vitin 2023.

Komuna kishte proceduar njoftimit për tatim pagueshit, mirëpo edhe për kunder kësaj, llogarit e arkëtueshme janë rritur.

Ndikimi Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitort mund të shkaktoj probleme në përmbaruesin e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbaruesin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikeve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,199,837	2,376,553	2,218,403	2,163,218	1,683,346
Grante Qeveritare - Buxheti	1,991,781	2,018,063	2,011,307	1,949,109	1,416,782
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	21,430
Të bartura nga viti i kaluar	0	147,964	82,728	102,629	91,910
Të hyrat vetanake	208,056	208,056	124,368	111,480	153,225
Donacionet vendore	0	18	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	2,452	0	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 176,716€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve vendore dhe të jashtme.

Në vitin 2024, janë shpenzuar 93.35% e buxhetit final ose 2,218,403€, me një rritje rreth 2.55% krahasuar me vitin 2023.

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,199,837	2,376,553	2,218,403	2,163,218	1,683,346
Pagat dhe mëditjet	1,445,893	1,472,175	1,471,340	1,442,894	1,102,859
Mallrat dhe shërbimet	246,660	284,362	268,041	223,589	216,446
Komunalitë	38,500	38,500	38,493	31,883	32,053
Subvencionet dhe transferet	62,000	62,400	56,892	51,664	58,886
Investimet Kapitale	406,784	519,116	383,636	413,188	273,101

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

-Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 26,282€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në 99.94% të buxhetit dhe përbëjnë 66.32% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 1.97% krahasuar me vitin 2023.


-Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 37,702€. Ky ndryshim është i lidhur me të hyrat vetanake. Shpenzimet për këtë kategori janë realizuar në 94.26% të buxhetit dhe përbëjnë 12.08% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 19.88% krahasuar me vitin e kaluar.

-Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur i njëjtë me atë fillestar, 38,500€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar afër 99.98% të buxhetit dhe përbëjnë 1.74% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 20.73% krahasuar me vitin 2023.

-Buxheti final për subvencione dhe transfere, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 400€. Kjo rritje është financuar nga të hyrat vetanake. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në 91.17% të buxhetit dhe përbëjnë 2.56% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë rritur me 10.12% krahasuar me vitin e kaluar.

-Buxheti final për investime kapitale është rritur për 112,332€ krahasuar me buxhetin fillestar. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i të hyrave të bartura dhe donacioneve. Shpenzimet janë realizuar afër 73.91% të buxhetit dhe përbëjnë 17.3% të shpenzimeve totale. Shpenzimet janë zvogëluar me 7.15% krahasuar me vitin paraprak.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2024 ishin në vlerë 155,651€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në prone në vlerë 98,144€, të hyrat jo tatimore në vlerë 57,507€, lejet e ndërtimit, taksa për regjistrimin e automjeteve, taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme etj. Po ashtu, Komuna për vitin 2024, kë pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë 11,966€, të cilati i alokohen për shpenzim në baza rregullta tremujore. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2023, ishin më të ulëta për 2.64% apo për 4,211€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	208,056	208,056	155,651	159,872	343,394
Të hyrat tatimore	127,505	127,505	98,144	113,500	96,238
Të hyrat jo tatimore	80,551	80,551	57,507	45,864	247,156
Të hyrat tjera	0	0		508	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Komuna e Junikut (KJ) ka identifikuar katër (4) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KJ ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar. Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, dy (2) nga rekomandimet janë zbatuar me sukses, ndërsa një (1) ende nuk është adresuar dhe një (1) rekomandim është mbyllur. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të marr veprime që punonjësit e transferuar në institucionet tjera të largohen nga lista e pagave të punonjësve të komunës.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë përpilimin dhe nënshkrimin e planit të menaxhimit të kontratës dhe nënshkrimin e tyre nga të dyja palet në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kontratës sipas kushteve të parapara.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
3.	Çështjet e përbashkëta	Nxjerrja e udhërblerjeve pas nënshkrimit të kontratës. Verifikimi i disponueshmërisë së mjeteve financiare para përfundimit të puënve apo shërbimeve.	Nuk janë ndërmarrë veprimet, i mbyllur.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se pasuritë nën 1,000€, regjistrohen në regjistrat kontabël të pasurive dhe të ndërmarr veprime për funksionalizimin e sistemit e-pasuria.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit




Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi i pa saktë i shpenzimeve	Bazuar ne Qarkoret Buxhetore 2024/01 dhe 2024/02 dhe në dokumentet tjera ligjore për planifikimin e buxhetit komunal nuk është lejuar që të buxhetohet dhe të planifikohen shpenzimet të cilat dalin si obligime nga kontrata kolektive në arsim, gjithashtu ekzekutimi i pagesave sipas urdhrave përmbarimor/gjyqësor është bërë nga Thesari dhe përkundër njoftimit që ne kemi insistuar që këto shpenzime të bëhen në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.	E gjetura qëndron.
Mbivlerësimi i të hyrave	Sa i përket Nenit 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit në faqen 4 të Pasqyrave financiare është prezantuar vlera e të hyrave jo tatimore në shume prej 69,000.00 që i përfshinë edhe gjokat e trafikut, kjo është bërë për arsye se në vitin e kaluar gjatë fazës së auditimit na është sugjeruar që ta prezantojmë në këtë mënyrë kurse sa i përket shpalosjes së këtij shënimi; Tek Shënimi 9 të hyrat jo tatimore të prezantuar në faqen 14 të pasqyrave financiare është e prezantuar dhe shpalosur në mënyrë të drejtë dhe nuk janë të përfshira të hyrat nga gjokat e trafikut dhe janë të specifikuara që këto të hyra nuk janë të përfshira.	E gjetura qëndron.

Dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtoreve	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk varet nga Komuna e Junikut por nga Niveli Qendror, Zjarrfikësit sipas akt emërimeve janë punëtor të MPB përkatësisht AME (Agjensioni për menaxhim emergjent) dhe kjo dukuri është e njëjtë në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës nuk është kjo gjendje vetëm në Komunën e Junikut dhe nuk mundet si e vetme të bëjë këtë zgjidhje. Kurse pylltarët me hyrjen në fuqi të ligjit të parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna” këta punëtor kanë kaluar në menaxhim të MMPHI përkatësisht Drejtorisë së parkut nacional Bjeshkët e Nemuna, Kjo dukuri është e njëjtë në të gjitha komunat të cilat janë pjesë e parkut nacional siç janë Komuna e Junikut, Deçanit, Gjakovës, Pejës dhe Istogut.	E gjetura qëndron.
--	--	---------------------------





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIQUE OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Junikut, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Nuk pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe kam disa komente për përmbajtjen e Raportit të bashkangjitur në Shtojcën I për gjetjet, Çështja A 1 - Klasifikimi i pasaktë i shpenzimeve e cila ka ndikuar edhe në kualifikimin e opinionit dhe ne mendojmë që ky kriter nuk duhet të jetë kriter për kualifikim të opinionit pasi që ky klasifikim i pasaktë i shpenzimeve është bërë nga ekzekutimi i pagesave nga Thesari për vendime përmbarimore dhe ne si Komunë nuk kemi pasur bazë ligjore për planifikim dhe ekzekutim të këtyre shpenzimeve të kontratës kolektive në arsim, po ashtu të Çështja A3 dhe Çështja B1 të prezantuara në shtojcën I; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ruzhdi Shehu

Kryetar i Komunës së Junikut

Data: 16. Qershor, 2025, Junik

Nënshkrimi: 

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.